



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:266525

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06873979

**C-IV-14-7631**

*Ankuesja:*

**Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike** me seli në Prishtinë.

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “BIP”**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me datë 10 shkurt 2025, lëshon këtë:

### A K T G J Y K I M

**1.REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.MIT139-0002 i datës 19 nëntor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**2.Ankuesja lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datë 26 dhjetor 2014, ankuesja ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) ka ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit nr. MIT139-0002 i datës 19 nëntor 2014të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) Zyra Rajonale në Mitrovicë për NSH “BIP” , me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim e fatuarave të pa paguara për periudhën korrik 2002 deri në shtator 2013, për shifrën DPR-9002662. Ankuesja ka deklaruar se AL-ja gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe të drejtën materiale pasi në mënyrë të pa drejtë është thirrur në vjetërsim të kërkesës, duke shtuar se NSH “BIP”(Industria e Birrës dhe pijeve jo alkoholike, në likuidim), jo vetëm që e ka ndërprerë parashkrimin, mirëpo edhe e ka pranuar borxhin në kuptim të nenit 387 të LMD-së ku thuhet se “ parashkrimi ndërpritet kur

debitori e pohon borxhin, dhe se pohimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyrë indirekte siç është dhënia e kësteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit”. Duke shtuar se edhe përlllogaritja e shumës për periudhën për të cilën është aprovuar kërkesa për kompensimin e faturave është llogaritur në mënyrë të gabuar. Andaj, ka kërkuar nga gjykata ta prish vendimin e AL-së për pjesën e refuzuar të kërkesës dhe ta aprovoj kërkesën e KEDS-it për shumën prej 227.40 €. Ankuesja si provë ka bashkangjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar të AL-së si dhe transaksionin e konsumatorit nën shifrën DMI-9002662.

Me datë 21 janar 2025, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankueses duke shtuar se e drejta për kompensimin e faturave të pa paguara ka humbur për shkak të kalimit të kohës. Tutje ka shtuar se gjendja faktike nuk mund të vërtetohet pasi nuk mund të gjindet ajo orë matëse dhe nuk mund të kalkuloohen shpenzimet e asaj kohe dhe se nuk ka prova me të cilat do të vërtetohej si janë krijuar saktë këto shpenzime dhe si ka ardhur deri te grumbullimi i këtij borxhi. Andaj, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 360 par.1 nën par. 1.1 parasheh se “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake parashkruhen në afat prej 1 viti”.

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesës i është njohur një pjesë e borxhit për faturat e pa paguara ashtu sic është vendosur edhe me vendimin e atakuar në ankesë mirëpo, kontestues është fakti se a i takon e drejta e kompensimit edhe për pjesën tjetër të shumës së kërkuar kjo për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit të kërkesës duke u bazuar në LMD. Po ashtu kontestues ishte edhe fakti i mënyrës së krijimit të këtyre shpenzimeve pasi nuk dihet se kush e ka shfrytëzuar atë orë në atë periudhë, NSH-ja apo persona të tjerë të cilëve objekti i është lëshuar me qira. Ankuesja si provë kishte bashkangjitur: kopjen e vendimit të kundërshtuar të AL-së si dhe transaksionin e konsumatorit nën shifrën DMI-9002662.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesja e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. E njëjta nuk është e paisur me prova se kush ka qene shfrytëzues i orës së konsumatorit me shifër DMI-9002662 si dhe faktit se si janë grumbulluar këto shpenzime dhe pse të njëjtat kanë mbetur pa u paguar pasi ankuesja nuk ka shpjeguar asryet se pse e njëjta nuk ka bërë përpjekje për inkasimin e të njëjtave në afate më të shkurta mirëpo, ka lejuar grumbullimin e një borxhi të tillë dhe të njëjtin e ka kërkuar krejt pas daljes së NSH në likuidim. Gjykata vlerësoj edhe pretendimin e të paditurës AL e cila më të drejtë në mbrojtjen e dorëzuar ka theksuar se e drejta e kërkesës është parashkruar dhe gjeti se një pretendim i tillë qëndron duke u bazuar në nenin 360 par. 1, nën par.1.1 andaj edhe e ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar. Gjykata vlerësoj edhe pretendimin e ankuesës së parashkrimi është ndërprerë me rastin e bërjes së pagesave nga ana e konsumatorit mirëpo, gjeti se një pretendim i tillë nuk qëndron kjo për faktin se nga transaksioni i konsumatorit me numër DMI-9002662, shihet se me datë 26 qershor 2006 konsumatori kishte paguar të gjithë borxhin ndaj tani ankueses dhe duke vazhduar në muajt pasues nuk ka pasur asnjë shpenzim dhe pagesë për të bërë kësaj kompanie për shërbimet e ofruara andaj, edhe nuk ka pasur ndërprereje të afatit të parashkrimit.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Në pajtim me nenin 13 par.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që vlera e kontestit është nën 1.000€.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a  
**Hajrie Shala**